

HISTORIKU I SHKOLLES “SHTJEFËN GJEÇOVI”

Duke u mbështeture në burimet arkivore të kohës dëshmohet qartë se kërkesën e parë për hapjen e shkollës në Janjevë e kishte bërë Imzot Andrea Bogdani, me 15 nëntore të vitit 1664, kur iu kishte drejtuar Organizatës së Kongregacionit të Shenjtë të Propagandes Fide në Romë, që për mësues të shkollës së vogël të Janjevës, siç e quante ai, të emërohej misionar apostolic, i afërmi i tij, hasjani Don Pjetër Mazrreku, i cili atëbotë sapo kishte mbaruar studimet në kolegjin Ilirik të Loretos në Itali, kurse shkolla ishte hapur në vitin 1665, para plotë 356 vjetëve. Për këtë shkollë një studiues diletant jo shqiptarë duke tentuar të mos e pranojë se shkolla punoi në gjuhën shqipe, thotë se ajo shkollë punoi në gjuhën ilire e dalmate.

Deri në vitin 1941 nxënësit shqiptarë mësimet i ndejknin në shkolla fetare ku mësimi zhvillohej në gjuhën turke, arabe dhe kroate.

Në vitin 1941 dhe 1942 kjo shkollë ia filloi punën me katër klase (klasa I –IV) dhe kishte 96 nxënës me mësimdhënës nga Shqipëria. Në vitin 1944 me ardhjen e partizanëve është mbyllur shkolla në gjuhën shqipe për tu rihapë në vitin 1947 me mësues Qazim Konxheli dhe mësimi zhvillohej deri në klasën e IV, në vitin 1954 shkolla u shëndrua në tërë vjeqare të plotë.

Shkolla fillore Vlladimin Nazore në Janjevë me paralelet në Akllap, Brus, Hanrovc, Terbovc në vitin shkollorë 1990-1991 kishte 707 nxënës me mësim në gjuhën shqipe të sistemuar në 34 paralele. Po në këtë vit shkollorë shkolla e Janjevës kishte dhe 580 nxënës të perkatesies kroate, rome dhe gorane.

Në këtë vit kuvendi i Serbisë ju kishte ndaluar hyrje në lokalet zyrtare shkollorë të gjithë atyre mësimdhënësve të cilët nuk punojnë sipas planprogrameve serbe, pas qe u penguan të hyjnë në objektin shkollorë nxënësit dhe arsimetaret mësimet i vazhduan në lokale private.

Qytetarët e Janjevës ju pergjigjen duke leshuar shtëpitë e tyre për nevojat e shkollës dhe asnjëherë nuk do të harrojmë kontributin e prindëve të nxënësve shqiptarë të cilët afruan shtëpitë e tyre privat për të mbajtur mësimin dhe atyre familjve do të jemi mirënjohës andaj dhe sot i falenderojmë.

Me propozimin e këshillit të shkollës, prindëve dhe OJQ, shkolla u pagezua me emrin Atë Shtejfën Gjeçovi në vitin 1991. Shkolla këtu erdhi me krenari deri në vitin 1999 kur Kosova u çlirua falë gjakut të luftetarëve shqiptarë dhe ndimes se faktorit ndërkombëtarë, po në këtë vit, në u rikthyem në objektin shkollorë por pas kundërshtimit që i bënë emrit të shkollës komunitetet, shkolla për 10 vite ishte pa emer dhe njëhej si shkolla e Janjevës. Pasi kërkesës të përbashkët të Klubit Letrar “Shtejfën Gjeçovi”, drejtorisë së shkollës, këshillit të saj, strukturave politike dhe OJQ-ve të Janjevës me rrethine dhe mbështetjes së fuqishme nga DKA

dhe kryetarit të komunes zotri Shukri Bujes, me 20 qershor të vitin 2009 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë bëne pagëzimin zyrtar të shkolles fillore në janjeve me emrin Atë Shtjefën Gjeçovi dhe ngritjen e bustit në oborrin e shkolles.

Rikthimi i emrit të shkolles, vendosja e bustit të Atë Shtjefën Gjeçovit, shpërndarja e librave për të gjithë nxënësit, sjellja e shumë kuadrave të ri në shkollën amë dhe paralelën në Brus si dhe bartja e nxënësve nga fashati Teqe dhe lagjja Metaliku, rregullimi i shkollave nga OSBE dhe DKA, të cilët i falimenderojmë, aplikim të teknikave të reja të mesimdhënes kanë rritur motivin për punë si rezultate kemi pjesëmarrjen e nxënësve në gara nacionale dhe komunale në cilin është arritur një sukses i krenar. Gjate këtij viti shkollor shkolla ka vazhduar bashkpunimin me OJQ me KFORIN, World Vision dhe personalitete të deshuara të cilët e kanë ndimuar bibliotekën e shkolles me 300 libra të reja veqanarisht vlen të përmendet Klubi Rotarian "Prishtina", udhëheqesi i saj Shqiptar Demaqi dhe Isuf Kelmendi i cili për të dytën herë e ka ndimuar bibliotekën me tituj të ri në emër të shkolles kanë një falenderim të veçantë.

Gjatë vitit shkollor 2020-2021 shkolla është paisur nga DKA-ja me disa lloptop dhe projektor për ta lehtësuar procesin mësimor në shkollë. Po ashtu janë rregulluar dy kabinete të informatikës me të gjitha paisjet teknologjike të reja nga KFORI-TURK njëri për nxënësit shqiptar dhe tjetri për komunitetet.

Në vitin shkollor 2021-2022 shkolla ka 320 nxënëse, 50 prej tyre janë të komunitetit kroat, romë goran dhe boshnjak, të gjithë këto komunitete mësojnë me të njëjtën ndërtesë mësimore, ku mësimi zhvillohet në një ndërrim dhe në paralelën e ndarë në Brus mësimi zhvillohet në dy ndërrime. Për zhvillimin e procesit mësimor janë të angazhuar 27 mesimdhënës shqiptar, 20 të komunitetit dhe 9 punëtor ndimës.